



# UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË

## RAPORT

### MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË PËR PERIU DHËN JANAR 2021 – DHJETOR 2021

*Ky raport është përpiluar nga Prof. Asoc. Dr. Agim Rysha, Kryetar i Komisionit për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë*

**Janar 2022**

## **Përmbledhje**

Universiteti “Haxhi Zeka” (UHZ) ka hartuar strategjinë e re pesëvjeçare 2020-2024 e cila pasi që është aprovuar ka filluar së zbatuari që nga fillimi i vitit 2020.

Në këtë raport është paraqitur progresi në zbatimin e dokumentit strategjik për vitin 2021. Monitorimi i zbatimit të strategjisë është bërë në baza tremestrale ku komisioni për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2021 ka mbajtur takime duke evidentuar progresin e arritur pas tremujorit të parë, tremujorit të dytë, ndërsa progresin e arritur për dy tremujorët e fundit të vitit 2021 komisioni e ka evidentuar në fund të vitit 2021, përkatësisht në fund të vitit 2022.

Raporti përmban të dhënat dhe rezultatet nga monitorimi i zbatimit të strategjisë së UHZ-së, dhe përfshinë periudhën kohore Janar – Dhjetor 2021 (shih shtojcën 1)

Monitorimi i zbatimit të planit strategjik është bërë nga Komisioni për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë në mënyrë periodike përgjatë gjithë vitit 2021 dhe përfshinë monitorimin e objektivave strategjike në këto fusha:

1. Menaxhimi dhe administrata
2. Mësimdhënia dhe të mësuarit
3. Sigurimi i Cilësisë
4. Kërkimi shkencor
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-institucional
6. Studentët
7. Infrastruktura

Në planin strategjik për vitin 2021 ishin të planifikuara gjithsejtë 139 aktivitete të shpërndarë në shtatë fushat strategjike: Menaxhimi dhe administrata (20 aktivitete); Mësimdhënia dhe të mësuarit (29 aktivitete); Sigurimi i Cilësisë (11 aktivitete); Kërkimi shkencor (26 aktivitete); Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-institucional (10 aktivitete); Studentët (30 aktivitete) dhe Infrastruktura (13 aktivitete)

Nga aktivitetet e planifikuara për vitin 2021, është vërejtur progres në disa prej fushave strategjike, ndërsa në disa nga fushat strategjike ka edhe aktivitete në të cilat nuk ka pasur progres ose progresi ka qenë i mjaftueshëm.

Gjatë vitit 2021 ka pasur progres te plotësimi dhe përditësimi i ueb faqes së universitetit duke përfshirë edhe pasurimin e SEMS-it me shërbime. Progres është vërejtur gjithashtu edhe sa i përket hartimit të planeve vjetore të punës dhe aktiviteteve të personelit akademik, organizimit të disa trajnime të stafit akademik si dhe te vizitave të personelit akademik dhe studentëve në universitete perëndimore. Përkundër pandemisë, disa njësi akademike kanë arritur të organizojnë disa ligjërata nga ligjëruesit mysafirë. Ka pasur progres modest edhe në pasurimin e bibliotekës me tituj të librave. Gjatë vitit 2021 janë akredituar dy programe në nivelin master. Progres është shënuar në shumicën e aktiviteteve që ndërlidhen me vlerësimin e sigurimit të

cilësisë. Përgjatë vitit 2021, instrumentet e vlerësimit të cilësisë janë përdorur dy herë, ndërsa është shënuar progres edhe sa i përket transparencës gjatë procesit të sigurimit të cilësisë. Raportet për vlerësimin e cilësisë janë përfunduar dhe publikuar.

Sa i përket kërkimit shkencor, gjatë vitit 2021 edhe pse në numër jo të madh, janë realizuar disa hulumtime në bashkëpunim me universitetet/kolegët ndërkombëtarë dhe me universitetet/kolegët vendorë. Ka pasur përparim edhe sa i përket realizimit të hulumtimeve aplikative. Përkundër pandemisë, nuk kanë munguar edhe hulumtimet në bashkëpunim me kolegët nga brenda UHZ. Gjatë vitit 2021, stafi akademik është përkrahur për publikime në revista shkencore ndërkombëtare ndërsa për arsye të pandemisë, pjesëmarrja e tyre në konferenca ndërkombëtare ishte e ulët. Megjithatë, një numër i stafit akademik ka marrë pjesë në konferenca të organizuara online. Gjatë vitit 2021 përkundër pandemisë UHZ ka arritur që të krijojë disa partneritete të reja me universitete ndërkombëtare dhe t'i ripërtërijë disa të tjera. UHZ, edhe gjatë vitit 2021 ishte e përfshirë në realizim e disa projekteve të përbashkëta ndërkombëtare si dhe në zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimeve me universitete vendore e ndërkombëtare. Gjatë vitit 2021, KSHC ka aprovuar programin master në bujqësinë urbane (UHZ dhe UP) ndërsa në fakultetin e Agrobiznesit është aprovuar dhe akreditura programi në nivelin Master "Sistemet e qëndrueshme të prodhimit të ushqimit" me përkrahje të projektit STEPS. Fakultet. Fakulteti i Agrobiznesit ka arritur gjithashtu që të akreditojë edhe programin profesional (LLL). Gjatë vitit 2021 Qendra për Zhvillimi të Karrierës (QZHK) është fuqizuar dhe ka qenë mjaft aktive. Kjo zyrë në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim dhe Informim të UHZ-së ka zbatuar shumë aktivitete në shërbim të studentëve. Sa i përket infrastrukturës, progresi ishte më i kufizuar, megjithatë është vërejtur progres në pajisjen e sallave, rinovimin e disa objekteve si dhe ofrimit të qasjes në internet në hapësirat universitare. Progres është shënuar edhe sa i përket pajisjes së kabineteve të informatikës dhe sallave të ligjëratave me pajisje dhe inventarë.

Gjatë vitit 2021 kishte edhe aktivitete në të cilat nuk kishte progres ose progresi ishte i pamjaftueshëm.

Ngecje ka pasur në rishikimin e shumë rregulloreve, kodeve, strategjive sektoriale, dhe doracakëve të cilët ishin zhvilluar gjatë vitit 2020 ndërsa ishte planifikuar që të bëhej rishikimi i tyre gjatë vitit 2021. Gjatë vitit të kaluar nuk është raportuar të ketë pasur progres edhe rreth gjenerimit të hyrave vetanake përmes ofrimit të shërbimeve dhe projekteve për palët e interesuara. UHZ nuk ka arritur akoma pavarësinë financiare. UHZ, gjatë vitit 2021 nuk arriti që të akreditojë programe studimore në nivel të doktoratës. Progresi ka munguar edhe sa i përket përfshirjes më të madhe të punës praktike në kuadër të studimeve. Gjatë vitit 2021, progresi ka vazhduar të mungojë në disa aktivitete të planifikuara siç është trajnimi i stafit përgjegjës të disa zyrave të UHZ-së. Jo të gjitha aktivitetet e planifikuara për veprimtari dhe krijimtari artistike janë realizuar për arsye të COVID 19. Progres i pamjaftueshëm në fushën e kërkimit shkencor gjatë vitit 2021 është vërejtur në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me themelimin dhe

funksionalizimi i Instituteve hulumtuese në nivel universiteti dhe në nivel të njësive akademike. Progresi ka munguar edhe sa i përket realizimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë për hartimin e projekteve hulumtuese që ka rezultuar me mos zbatimin edhe të aktiviteteve që ndërlidhen me organizimin e trajnimeve nga stafi i brendshëm i UHZ-së. Progres nuk është shënuar edhe sa i përket krijimit të revistës shkencore ndërkombëtare të UHZ-së. Nuk është vërejtur progres në përdorimin e softuerit për identifikimin e plagjiaturës së temave të diplomës edhe pse është hartuar rregullorja për anti – plagjiaturë. Nuk ka pasur progres edhe sa i përket ofrimit të mundësive për mësimin e gjuhës angleze për studentët si dhe ka dështuar organizimi i Konferencës Rajonale Shkencore të Studentëve. Nuk kishte progres edhe sa i përket organizimi i aktiviteteve edukative, artistike, kulturore, sociale, sportive e rekreative për/nga studentët e UHZ-së. Sa i përket infrastrukturës, gjatë vitit 2021 është punuar në ndërtimin e fakultetit të arteve por nuk është arritur që të përfundohet ashtu siç ishte paraparë. Edhe gjatë vitit 2021 nuk janë krijuar hapësira të tjera për stafin dhe studentët për shkak të vonësës në ndërtimin e fakultetit të arteve ndërsa ndërtimi i fakultetit të biznesit nuk ka filluar akoma së ndërtuari.

## Hyrje

Universiteti "Haxhi Zeka në Pejë që nga fillimi i vitit 2020 është duke zbatuar Strategjinë zhvillimore për periudhën 2020-2024 e cila ishte aprovuar në fillim të vitit 2020 me objektiva strategjike për menaxhim dhe administratë efikase, transparente dhe llogaridhënëse; mësimdhënie cilësore me metoda e teknologji bashkëkohore dhe programe atraktive; sistem i konsoliduar i sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare; veprimtari kërkimore dhe krijimtari artistike cilësore që i kontribuon zhvillimit të shoqërisë; bashkëpunim intensiv ndërkombëtar dhe ndër-institucional; shërbime dhe aktivitete të shumta e cilësore për studentët dhe infrastrukturë e mjaftueshme, bashkëkohore dhe e mirë-pajisur.

Ky raport përfshinë rezultatet nga monitorimi i zbatimit të strategjisë përgjatë vitit 2021 të cilat kanë të bëjnë me:

- Vlerësimet rreth përmbushjes së objektivave nga fillimi deri në fund të vitit 2021
- Përcaktimin e prioriteteve kryesore për vitin e ardhshëm

Procesi i rishikimit të zbatimit të strategjisë për vitin 2021 ka përfshirë:

- Takimet me Komisionin e emëruar për monitorimin e zbatimit të strategjisë së Universitetit "Haxhi Zeka"
- Grumbullimin e të dhënave nga të gjitha njësitë akademike dhe organet drejtuese të Universitetit rreth zbatimit të aktiviteteve nga plani strategjik për vitin 2021
- Krahasimi i të dhënave të grumbulluara me aktivitetet e planifikuara për vitin 2021

## Konteksti

Në planin strategjik të veprimit për vitin 2021 ishin përcaktuar aktivitetet sipas objektivave strategjike përmes të cilave UHZ do të realizonte më së miri misionin e tij.

Ky raport merr në konsideratë aspektet që kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve gjatë vitit 2021.

## Progresi i arritur gjatë vitit 2021

Plani strategjik i veprimit për vitin 2021 i numëron shtatë objektiva strategjike në kuadër të së cilave janë shumë nën-objektiva të tjera. Objektivat bazë për vitin 2021 ishin po ato objektiva, të cilat i përmbante strategjia pesë vjeçare e UHZ-së. Progresi i arritur gjatë vitit 2021 është paraqitur sipas shtatë objektivave strategjike.

Në kuadër të objektivave dhe nën objektivave strategjike, plani i veprimit për vitin 2021 numëronte rreth 139 aktivitete/projekte për tu realizuar përgjatë vitit 2021. Të dhënat nga monitorimi tregojnë se është arritur progres në disa aktivitetet të planifikuara. Përditësimet e detajuara për progresin sipas objektivave janë paraqitur në shtojcën e këtij raporti.

Përshkrimi i progresit në zbatimin e aktivitetet kryesore të ndërmarra sipas planit të veprimit për vitin 2021 është paraqitur pas monitorimit periodik të zbatimit të aktiviteteve të planifikuara për secilën fushë strategjike.

### ***Menaxhimi dhe administrata***

Objektivi strategjik në këtë fushë ishte “Menaxhim dhe administratë efikase, transparente dhe llogaridhënëse”. Për vitin 2021, qenë planifikuar 20 aktiviteteve në këtë fushë strategjike.

Nga aktivitetet e planifikuara është vërejtur progresi në disa prej tyre, në disa kishte progres të pamjaftueshëm ndërsa kishte edhe aktivitete në të cilat është vërejtur se nuk ka pasur progres. Progresi është vërejtur në identifikimin e nevojave të personelit për trajnime si dhe në promovimin e bashkëpunimit dhe punës ekipore. Ka pasur progres edhe te plotësimi dhe përditësimi i ueb faqes së universitetit duke përfshirë edhe pasurimin e SEMS-it me shërbime të reja. Gjatë vitit 2021, personeli akademik është trajnuar për përdorimin e moduleve shtesë të SEMS-it. Është vërejtur gjithashtu progres edhe sa i përket hartimit të planeve vjetore të punës dhe aktiviteteve të personelit akademik. Në këtë fushë strategjike ka pasur edhe ngecje dhe progres të pamjaftueshëm sidomos në funksionalizimin e plotë të disa mekanizmave të rinj brenda universitetit siç janë ZPM, ZKSH ZBN, “Qendra për Inovacion” dhe “Qendra nga teoria në praktikë”. Ngecje ka pasur edhe në rishikimin e shumë rregulloreve, kodeve, strategjive sektoriale, dhe doracakëve të cilët ishin zhvilluar gjatë vitit 2020 ndërsa ishte planifikuar që të bëhej rishikimi i tyre gjatë vitit 2021. Nga fundi i vitit 2021, UHZ-së i është premtuar përkrahja nga projekti HERAS që të rishikohet e gjithë rregulltave gjatë vitit 2022. Përkundër përpjekjeve dhe lobimit, gjatë vitit të kaluar nuk është vërejtur progres edhe sa i përket pavarësisë financiare. Kërkesa për pavarësi financiare janë parashtruar gjatë vitit 2021 duke përfshirë edhe kërkesën e përbashkët me Universitetet tjera publike përveç UP e cila është bërë në muajin dhjetor të vitit 2021. Gjatë vitit të kaluar nuk është raportuar të ketë pasur progres edhe rreth gjenerimit të të hyrave vetanake përmes ofrimit të shërbimeve dhe projekteve për palët e interesuara

### ***Mësimdhënia dhe të mësuarit***

Kjo fushë ka si objektivi strategjik “mësimdhënien cilësore me metoda e teknologji bashkëkohore dhe programe atraktive”. Për vitin 2021 ishin planifikuar 29 aktivitetet dhe në shumicën e tyre është shënuar progres, por janë disa aktivitete në të cilat nuk ka pasur përparim të mjaftueshëm. Aktivitetet në të cilat ishte planifikuar punësimi, avancimi dhe përkrahja e personelit të sapo punësuar akademik, janë zbatuar gjatë vitit 2021. Aspekti gjinor është përfillur gjatë punësimit të stafit akademik. Gjatë vitit 2021 ka qenë i publikuar orari i konsultimeve me studentë, ndërsa zyra për përsosmëri në mësimdhënie që ishte krijuar në vitin paraprak ka funksionuar përkundër numrit të kufizuar të të punësuarve. Gjatë vitit 2021 përkundër kufizimeve që ka shkaktuar pandemia, janë organizuar disa trajnime të stafit akademik për metodat bashkëkohore të

mësimdhënies kryesisht të përkrahura nga projektet e ndryshme ndërkombëtare. Gjatë vitit 2021 kishte vizita të personelit akademik dhe studentëve në universitete perëndimore, edhe këto të mbështetura nga projektet ndërkombëtare. Përkundër pandemisë, disa njësi akademike kanë arritur të organizojnë disa ligjërata nga ligjëruesit mysafirë. Ka pasur progres modest edhe në pasurimin e bibliotekës me tituj të librave. Gjatë vitit 2021 janë akredituar dy programe në nivelin Master. Aktivitetet e planifikuara në këtë fushë, në të cilat kishte ngecje ishin aktivitetet që ndërlidhen me mos akreditimin e programeve studimore në nivelin e doktoratës. Edhe te aktiviteti i planifikuar për fuqizimin e sistemit tutorial kishte më pak angazhim gjatë vitit 2021. Komision nuk ka arritur të evidentojë progres edhe sa i përket përfshirjes më të madhe të punës praktike në kuadër të studimeve. Gjatë vitit të kaluar, përkundër krijimit të komisionit, nuk është arritur që të hartohet manuali për vlerësimin e performancës së programeve të studimit. Progresi ka munguar edhe sa i përket publikimit të librave universitarë.

### ***Sigurimi i cilësisë***

Objektivi strategjik në fushën e sigurimi të cilësisë është “Sistem i konsoliduar i sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare”. Gjatë vitit 2021 në këtë fushë strategjike qenë planifikuar njëmbëdhjetë aktivitete. Gjatë vitit 2021 është shënuar progres në shumicën e aktiviteteve që ndërlidhen me vlerësimin e cilësisë duke përdorë instrumentet e zhvilluara për vlerësimin e sigurimit të cilësisë. Përgjatë vitit 2021, instrumentet e vlerësimit të cilësisë janë përdorur dy herë, ndërsa është shënuar progres edhe sa i përket transparencës gjatë procesit të sigurimit të cilësisë. Raportet për vlerësimin e cilësisë janë përfunduar dhe publikuar. Progres ka pasur edhe sa i përket përpunimit dhe përdorimit të të dhënave statistikore të cilat janë përpunuar dhe publikuar. Edhe gjatë vitit 2021, progresi ka vazhduar të mungojë në disa aktivitete të planifikuara siç është trajnimi i stafit përgjegjës për Sigurim të Cilësisë (SC) i cili nuk është kryer për stafin e Zyrës për Sigurim të Cilësisë (ZSC) në nivel universiteti dhe stafin e Zyrave të Koordinatorëve të Cilësisë (ZKC) në nivel të njërive akademike/fakulteteve. Nuk ka filluar gjithashtu trajnimi i stafit për përpunim dhe raportim të dhënave dhe statistikave.

### ***Kërkimi shkencor***

Objektivi strategjik në këtë fushë është “Veprimtari kërkimorë dhe krijimtari artistike cilësore që i kontribuon zhvillimit të shoqërisë”. Janë gjithsejtë njëzet e gjashtë aktivitete të planifikuara në këtë fushë strategjike. Gjatë vitit 2021 është bërë ndarja e buxhetit të veçantë për kërkime shkencore, ndërsa stafi akademik ka hartuar projekte hulumtuese dhe 5 prej tyre janë miratuar. Për arsye të ekzekutimit me vonesë të pagesave nga Ministria, projektet hulumtuese do të vazhdojnë të realizohen edhe gjatë vitit 2022. Gjatë vitit 2021 edhe pse në numër jo të madh, janë realizuar disa hulumtime në bashkëpunim me universitetet/kolegët ndërkombëtarë dhe me universitetet/kolegët vendorë. Ka pasur përparim edhe sa i përket realizimit të hulumtimeve

aplikative. Përkundër pandemisë, nuk kanë munguar edhe hulumtimet në bashkëpunim me kolegët nga brenda UHZ. Një numër i studentëve është përfshirë në hulumtime shkencore. Stafi akademik është përkrahur për publikime në revista shkencore ndërkombëtare. Për arsye të pandemisë, pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca ndërkombëtare gjatë vitit 2021 ishte e ulët. Megjithatë, një numër i stafit akademik ka marrë pjesë në konferenca të organizuara online. Gjatë vitit 2021, fakulteti Juridik në bashkëpunim me fakultetin e Arteve të UHZ-së dhe në cilësinë e bashkë organizatorit edhe me Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës dhe të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në muajin nëntor 2021 kanë organizuar konferencën ndërkombëtare ICLA 2021.

Për shkak të pandemisë konferenca ndërkombëtare që organizohet nga FB është shtyrë për vitin 2022. Jo të gjitha aktivitetet e planifikuara për veprimtari dhe krijimtari artistike janë realizuar për arsye të COVID 19. Progres i pamjaftueshëm në fushën e kërkimit shkencor gjatë vitit 2021 është vërejtur në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me themelimin dhe funksionalizimi i Instituteve hulumtuese në nivel universiteti dhe në nivel të njërive akademike. Progresi ka munguar edhe sa i përket realizimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë për hartimin e projekteve hulumtuese që ka rezultuar me mos zbatimin edhe të aktiviteteve që ndërlidhen me organizimin e trajnimeve nga stafi i brendshëm i UHZ-së. Progres nuk është shënuar edhe sa i përket krijimit të revistës shkencore ndërkombëtare të UHZ-së

### ***Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-institucional***

Në vitin 2021 qenë planifikuar 10 aktivitete në funksion të realizimit të objektivit strategjik “Bashkëpunim intensiv ndërkombëtar dhe ndër-institucional”. Për vitin 2021 qe ndarë një buxhet i veçantë për bashkëpunim ndërkombëtar por kanë munguar aktivitetet kryesisht për arsye të COVID 19. Gjatë vitit 2021 përkundër pandemisë UHZ ka arritur që të krijojë disa partneritete të reja me universitete ndërkombëtare dhe t’i ripërtërijë disa të tjera. Janë nënshkruar 6 marrëveshje me universitete ndërkombëtare, ndërsa 5 janë rinovuar. Për arsye të COVID 19, kishte pak progres sa i përket hulumtimeve të përbashkëta me kolegë/universitete ndërkombëtare si dhe mobilitetit ndërkombëtar të stafit akademik dhe të studentëve. UHZ, edhe gjatë vitit 2021 ishte e përfshirë në realizim e disa projekteve të përbashkëta ndërkombëtare si dhe në zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimeve me universitete vendore e ndërkombëtare. Gjatë vitit 2021, KSHC ka aprovuar programin Master në bujqësinë urbane (UHZ dhe UP) ndërsa në fakultetin e Agrobiznesit është aprovuar dhe akredituar programi në nivelin Master “Sistemet e qëndrueshme të prodhimit të ushqimit” me përkrahje të projektit STEPS. Fakultet. Fakulteti i Agrobiznesit ka arritur që të akreditojë edhe programin profesional (LLL) nga AKK në fusha të bujqësisë

Gjatë vitit 2021, në disa njësi akademike ka vazhduar bashkëpunimi me institucione e biznese për harmonizimin e programeve me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës si dhe është emëruar një



koordinator për bashkëpunim ndërkombëtar. Nuk ka pasur progres në trajnimin e stafit për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndër-institucional.

### ***Studentët***

Objektivi strategjik në këtë fushë është “Shërbime dhe aktivitete të shumta e cilësore për studentët” dhe në funksion të realizimit të këtij objekti, për vitin 2020 ishin planifikuar tridhjetë aktivitete. Gjatë vitit 2021 Qendra për Zhvillimi të Karrierës (QZHK) është fuqizuar dhe ka qenë mjaft aktive. Kjo zyrë në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim dhe Informim e UHZ-së, ka vazhduar bashkëpunimin me shkollat e mesme të larta të komunave të rajonit të Pejës, ndërsa në kohën e regjistrimit të studentëve të rinj, UHZ ka organizuar “Ditët e Hapura” për studentët potencialë duke organizuar vizita informuese dhe shpërndarje të materialeve për promovim. Ka pasur edhe aktivitete si ligjërata “Të rinjtë për drejtësi” pastaj “Përfshirja e të rinjve në sistemin e drejtësisë dhe pjesëmarrja në vendimmarrje në nivel komunal”, Ligjërata virtuale për shkathtësi të buta; Trajnim për funksionimin e asamblesë komunale Ligjërata online “Njohja e vetvetes-testet e karrierës” Ligjërata online me përfaqësuesit e Gjykatës Themelore Pejë si dhe sesion informues- Prezantimi i programit BPB Junior. Gjatë vitit 2021 `vazhdimisht është analizuar kalueshmëria e studentëve dhe raportet janë bërë pas çdo afati të provimeve. Zbatim i masave për studentët kopjues ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021. Në një njësi akademike janë raportuar disa raste të cilat janë duke u shqyrtuar në komisionin disiplinor. Gjatë vitit 2021 është vazhduar me ofrimin e shërbime të këshillimit për planifikimin e karrierës, përpilimin e CV-së, Letrës së Motivimit dhe informata të tjera me rëndësi për zhvillimin e karrierës. Janë mbajtur rreth 90 konsultime. Gjatë vitit 2021 është bërë edhe ofrimi i punës praktike për studentët përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit. Gjatë vitit 2021 studentët kanë marrë pjesë në gara vendore (garat e footsal në kuadër të federatës së sporteve universitare të Kosovës (FSUNK), Është raportuar se gjatë vitit 2021 Alumni janë përfshirë në vlerësimin dhe rishikimin e programeve dhe syllabuseve. Në fund të vitit është bërë ndarja e mirënjohjeve për Alumni që i kontribuojnë UHZ-së.

Progres i pamjaftueshëm është vërejtur sa i përket adresimit të mos-përgatitjes së mirë të nxënësve gjatë shkollimit paraprak. Nuk është vërejtur progres në përdorimin e softuerit për identifikimin e plagjiaturës së temave të diplomës edhe pse është hartuar rregullorja për anti – plagjiaturë. Gjatë vitit 2021 për arsye të pandemisë nuk është organizuar Panairi i Karrierës dhe nuk kishte pjesëmarrje në panairë të tjera. Mobiliteti i studentëve gjatë vitit 2021 ishte i ulët për arsye të COVID 19. Është evidentuar mobiliteti i 10 studentëve nga MTHM (online) si dhe mobilitete tjera përmes projektit NAWA (9 studentë). Nuk ka pasur progres edhe sa i përket ofrimit të mundësive për mësimin e gjuhës angleze. Gjatë vitit 2021 ka dështuar organizimi i Konferencës Rajonale Shkencore të Studentëve. Nuk kishte progres edhe sa i përket organizimi i

aktiviteteve edukative, artistike, kulturore, sociale, sportive e rekreative për/nga studentët e UHZ-së. Për shkak të pandemisë nuk është organizuar takimit vjetor me Alumni

### **Infrastruktura**

Objektivi strategjik në fushën e infrastrukturës është “Infrastrukturë e mjaftueshme, bashkëkohore dhe e mirë-pajisur”. Për vitin 2020 për këtë fushë strategjike ishin të planifikuara trembëdhjetë aktivitete. Vetëm në disa prej tyre është vërejtur progres ndërsa ka disa aktivitete në të cilat progresi ishte i pa mjaftueshëm ose aktivitetet nuk kanë filluar fare së zbatuari. Gjatë vitit 2021 është punuar në ndërtimin e fakultetit të arteve por nuk është arritur që të përfundohet ashtu siç ishte paraparë. Gjatë vitit 2021 është punuar gjithashtu në rregullimi i hapësirave të jashtme si dhe ka pasur renovime në njësitë akademike. Progres është vërejtur në pajisjen e sallave të përbashkëta të studentëve dhe e korridoreve, si dhe në rinovimin e disa objekteve si dhe ofrimit të qasjes në internet në hapësirat universitare. Progres është shënuar edhe sa i përket pajisjes së kabineteve të informatikës. Ka pasur progres në pajisjen e sallave të ligjëratave dhe riorganizimin e inventarit. Nuk ka të dhëna se është përfunduar aktiviteti që ndërlidhet me pajisje me rekuizita dhe instrumente të Fakultetit të Arteve (FA). Edhe gjatë vitit 2021 nuk janë krijuar hapësira të tjera për stafin dhe studentët për shkak të vonës në ndërtimin e fakultetit të arteve. Nuk ka pasur progres në realizimin e aktivitetit që ndërlidhet me pajisjen e zyrave të stafit. Ndërtimi i fakultetit të biznesit nuk ka filluar së ndërtuari.

### **Mjedisi i jashtëm**

UHZ në vitin 2021 ka arritur që me sukses ta të akreditojë e ri akreditojë disa programe studimore në nivelin Bachelor dhe Master

UHZ, ashtu si edhe institucionet e tjera publike të arsimit të lartë, ka vazhduar që edhe gjatë vitit 2021 të varet nga buxheti i shtetit.

Kapacitetet e stafit akademik por edhe të administratës në institucionet publike mbeten të kufizuara ndërsa sfidë në vete mbeten investimet në infrastrukturë siç janë p.sh. laboratorët, hapësirat për personelin akademik, mensat, kampet sportive etj.

Lëvizja e lirë brenda kufijve të Evropës mbetet akoma e pa realizuar duke kufizuar mundësitë e punësimit jashtë vendit të rinjve kosovarë por edhe të studentëve që përfundojnë studimet në UHZ. Studentët vazhdojnë të shprejnë që në të ardhmen do të krijohet mundësia e lëvizjes së lirë, prandaj, është me rëndësi që sistemi i arsimit në Kosovë duke përfshirë edhe UHZ-në, t’i përshtatet kërkesave të tregut evropian të punës përmes ngritjes së cilësisë së studimeve.

Si përfundim mund të thuhet se mjedisi i jashtëm edhe gjatë vitit 2021, ka vazhduar të ofrojë disa mundësi siç është rritja e lehtë e buxhetit, por në anën tjetër rritja e papunësisë në vend, pamundësia e lëvizjes së lirë si dhe ulja demografike, mund të reflektojnë në të ardhmen edhe në uljen e interesimit të rinjve për të ndjekur studimet e larta.

## **Prioritetet afatshkurtra**

Të dhënat e grumbulluara rreth realizimit të aktiviteteve gjatë vitit 2021 tregojnë se përkundër progresit të arritur në disa fushat strategjike, fokusi i përpjekjeve në afatin e shkurtër do të vazhdojë që të jetë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përkundër disa arritjeve në këtë aspekt, ndërsa prioriteti tjetër do të jetë puna hulumtuese shkencore e studentëve dhe e personelit akademik në projekte të ndryshme hulumtuese shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi me sektorin privat dhe projektet e përbashkëta në të mirë të studentëve dhe komunitetit do të duhej të ishin prioritet i vazhdueshëm i UHZ-së. Pandemia e cila ka vazhduar përgjatë gjithë vitit 2021 ka bërë që shumë aktivitete të planifikuara të mbeten të pa zbatuara. Prandaj, UHZ gjatë zhvillimit të planit të veprimit për vitin 2022 do të duhej të konsideronte ndikimin që mund të ketë COVID 19 në aktivitetet e planifikuara për vitin 2022. Do të ishte mirë që për vitin 2022 të planifikoheshin edhe aktivitete të cilat në mënyrë alternative do të mund të zbatoheshin në formën “online” për të ulur kështu efektin negativ të COVID 19.

## **Prioritetet afatgjata**

UHZ është duke vazhduar me kompletimin e infrastrukturës në mënyrë që kampusi universitar të veprojë me tërë kapacitetin e tij. Gjatë vitit 2021 nuk është vërejtur ndonjë progres i theksuar sa i përket kompletimit të infrastrukturës, prandaj do të ishte mirë që UHZ ta konsiderojë çështjen e infrastrukturës me më shumë prioritet. Te gjeturat nga monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2021 tregojnë se UHZ është duke vazhduar që të konsolidojë programet dhe profilet aktuale studimore, por është e nevojshme që të planifikojë edhe zhvillimin e programeve të reja dhe shërbimeve të tjera që janë në funksion të zhvillimit të Pejës, Regjionit dhe të vendit në përgjithësi.

## **Përfundimet**

Si përfundim nga monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2021, mund të thuhet se UHZ ka avancuar në zbatimin e aktiviteteve në disa nga fushat strategjike të planifikuara me planin e strategjik pesë vjeçar, por është vërejtur se ka ngecje në aspektin e funksionalizimit të plotë të disa mekanizmave të rinj brenda universitetit siç janë ZPM, ZKSH ZBN, mbajtjes së trajnimeve dhe ngritjes së shkathtësive të personelit akademik, personelit administrativë si dhe të studentëve. Ngecje ka pasur edhe në rishikimin e shumë rregulloreve, kodeve, strategjive sektoriale, dhe doracakëve të cilët ishin zhvilluar gjatë vitit 2020 ndërsa ishte planifikuar që të bëhej rishikimi i

tyre gjatë vitit 2021. Ngecje kishte edhe në aktivitetet që ndërlidhen me mos akreditimin e programeve studimore në nivelin e doktoratës Progres i pamjaftueshëm është vërejtur në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me themelimin dhe funksionalizimi e “Instituteve Hulumtuese” në nivel universiteti dhe në nivel të njësive akademik por edhe sa i përket krijimit të revistës shkencore ndërkombëtare të UHZ-së. Edhe gjatë vitit 2021 nuk janë krijuar hapësira të tjera për stafin dhe studentët për shkak të vonesës në ndërtimin e fakultetit të arteve, ndërsa ndërtesa e fakultetit të biznesit nuk ka filluar akoma së ndërtuari.